



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTËAR



Tiranë më, 09.04.2024

V E N D I M

Nr.4, datë 09.04.2024

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 16.2.ç.), të këtij ligji, Këshilli Kombëtar,

V E N D O S I:

Të miratojë me 10 (dhjetë) vota Pro, Asnjë Kundër, 1 (një) Abstenim, propozimin e zyrës juridike në lidhje me aktivitetet e Edukimit në Vazhdim si më poshtë:

1. Të pezullohen përkohësisht të gjitha aktivitetet e vlefshme për procesin e Edukimit në Vazhdim të psikologëve, për një periudhë të pacaktuar kohore, deri në një vendimmarrje të dytë.
2. Psikologëve, të cilëve aktualisht u ka përfunduar periudha e vlefshmërisë së licencës së tyre dhe që bazuar në vendimin e KEVP-së i kanë plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve për rilicencim, të vijojnë me procesin e rilicencimit nga ana e Komisionit të Licencimit, pranë UP-së.
3. Psikologëve, të cilëve aktualisht e në vijim u ka përfunduar ose u përfundon periudha e vlefshmërisë së licencës së tyre dhe që nuk i kanë plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve për rilicencim, të vijojnë me ushtrimin e profesionit deri në një moment kur do të ketë një vendimmarrje tjetër nga ana e Këshillit Kombëtar.
4. Gjatë periudhës së pezullimit anëtarët e UP, nuk do të ngarkohen me detyrimin për marrjen e krediteve nga Urdhri i Psikologut.
5. Kjo periudhë të llogaritet sipas formulës së pezullimit për shkak të lejes së lindjes, masava disiplinore të dhëna nga Komisioni Etik.

PRESIDENTE E URDHRI



SEKRETARE

Armira BABOÇI

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email:
sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927